



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2023:244318

Datë: 05.02.2024

Numri i dokumentit: 05286915

C.nr. 404/23

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Fllanza Hashani, me bashkëpunëtore Albulena Morina-Lulaj, në çështjen juridike-kontestimore të paditësve: D. (B.) D. , L. (J.) D. dhe B. (S.) D. , që të gjithë nga K... , të cilët i përfaqëson i autorizuari F. G. , avokat në K... , kundër të paditurve: H. (I.) D. nga K... dhe ‘‘D...-R...’’ SH.P.K, me seli në K... , me bashkëpronar R. D. , B. D. dhe Sh. D. nga K... , me bazë juridike: anulim i punës juridike ose kompensim në të holla me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, jashtë seancës gjyqësore me datë 01.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e datës 10.11.2023, e paditësve: D. D. , L. D. dhe B. D. , kundër të paditurve: H. D. dhe ‘‘D...-R...’’ SH.P.K, me bashkëpronar R. D. , B. D. dhe Sh. D. , me bazë juridike: anulim i punës juridike ose kompensim në të holla me propozimin për caktimin e masës së sigurisë.

A r s y e t i m

Në këtë gjykatë, paditësit përmes të autorizuarit të tij kanë parashtruar padi me datë 10.11.2023, kundër të paditurve: H. D. dhe ‘‘D...-R...’’ SH.P.K, me bashkëpronar R. D. , B. D. dhe Sh. D. , me bazë juridike: anulim i punës juridike ose kompensim në të holla me propozimin për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, gjeti se padia nuk përmban adresën e saktë të paditurve. Gjykata me datë 27.11.2023, paditësve iu ka dërguar Aktvendim me shenjen C.nr. 404/23, për plotësim të padisë lidhur me adresën e saktë të vendbanimit-vendqëndrimit të të paditurve- kundërshtarëve të masës së sigurimit.

Mirëpo i autorizuari i paditësve me parashtresën e datës 29.12.2023, e ka njoftuar gjykatë që e tërheqë padinë dhe propozimin e masës së sigurisë në raport me të paditurit, pasi që kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Sipas nenit 261 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 261 lidhur me nenin 387 par. 1 pika c të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.404/23, datë 01.02.2024

Gj y q t a r j a:
Fllanza Hashani

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.